

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
Pml.-Kzz. Nr. 44/2013
Prishtinë
14 gusht 2013

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit dhe Gjyqtari i EULEX-it Bertil Ahnborg dhe Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Meleqe Bexheti si anëtarë të kolegjit, me Zyrtarin ligjor të EULEX-it Holger Engelmann, duke vepruar në cilësi të procesmbajtësit.

Në lëndën penale kundër:

J.V.
[Redacted]
[Redacted]
[Redacted]

I shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në kundërshtim të nenit 328 paragrafit 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) dhe i dënuar me një (1) vit burgim me anë të aktgjykimit të formës së prerë AP.-KŽ. 129/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 24 korrik 2012;

Duke vendosur në lidhje me Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë (kërkesën) të paraqitur më 27 nëntor 2012 nga avokati mbrojtës H. Q. në emër të pandehurit kundër aktgjykimit P. 259/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë, të datës 30 nëntor 2011, dhe aktgjykimit AP.-KŽ. 129/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 24 korrik 2012, duke vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur në emër të pandehurit [Redacted] **V.V.**
[Redacted] kundër aktgjykimit P. 259/2011 të Gjykatës së Qarkut në Pejë të datës 30 nëntor 2011, dhe aktgjykimit AP.-KŽ. 129/2012 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 24 korrik 2012, REFUZOHET SI E PABAZUAR.

ARSYETIM

Historia e procedurës

Më 30 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë me aktgjykimin P.nr. 259/11 ka shpallur të akuzuarin fajtor për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas nenit 328 paragrafit 2 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) dhe e ka dënuar atë me një vit burgim. Në të njëjtën kohë, propozim aktakuza për veprën penale Pjesëmarrje në rrahje sipas nenit 155 paragrafit 1 të KPK-së është refuzuar sipas nenit 389 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).

Më 24 korrik 2012, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykimin Ap-Kz 129/12 ka refuzuar ankesën e avokatit mbrojtës të të akuzuarit si të pabazuar sipas nenit 420 paragrafit 1 pikës 2 në lidhje me nenin 423 të KPPK-së.

Më 27 nëntor 2012, avokati mbrojtës i të akuzuarit ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjykimin të Gjykatës së Qarkut në Pejë dhe aktgjykimin të Gjykatës Supreme të Kosovës, duke pretenduar në shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 403 paragrafëve 1 dhe 3 të KPPK-së për arsye se dy seancat e para dhe seanca e fundit e shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur pa prezencën e të akuzuarit.

Gjetjet e gjykatës

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se kërkesa është e pranueshme por e pabazuar.

Pretendimet e mbrojtjes tregojnë shkeljen e parimit të gjykimin të drejtë siç është përcaktuar me nenin 6 paragrafin 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj) në dëm të të akuzuarit.

1. Mungesa e të akuzuarit gjatë dy ditëve të shqyrtimit gjyqësor:

Përkundër faktit se i akuzuari para gjykatës së shkallës së parë vazhdimisht ka qenë i përfaqësuar nga avokati i tij mbrojtës në çdo ditë të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se sipas procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor i akuzuari në të vërtetë nuk ka qenë prezent gjatë dy ditëve të para të shqyrtimit gjyqësor. Sidoqoftë, është konstatuar se i akuzuari ka qenë njëri nga katër të pandehurit në lëndë në gjykatën e shkallës së parë. Pasi që i akuzuari –edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt – nuk është paraqitur në gjykatë, nuk është marrë asnjë vendim formal për veçimin e lëndës së tij nga të tjerët. Në vend të kësaj, aktgjykimi i shkallës së parë thekson në faqen 5 se trupi gjyqësor ka rihapur shqyrtimin gjyqësor në lidhje me të akuzuarin më 3 nëntor 2011, e që ishte dita e tretë e shqyrtimit gjyqësor, kur ai është paraqitur për herë të parë në gjykatë. Gjithashtu në bazë të procesverbalit është konstatuar se gjatë dy ditëve të mëparshme të mungesës së tij në shqyrtim gjyqësor asnjëri nga dëshmitarët nuk ka dhënë deklaratë në lidhje me aktakuzën kundër të akuzuarit. Pas pjesëmarrjes së parë të të akuzuarit më 3 nëntor 2011, aktakuza kundër tij është lexuar dhe – me pajtimin e të gjitha palëve – procesverbali nga dy ditët e para të shqyrtimit gjyqësor është

konsideruar si i lexuar. Pastaj, i akuzuari është deklaruar fajtor për akuzën e mbetur kundër tij. Ai është shpallur fajtor në bazë të deklaratës së tij se gjatë natës së referuar të rrahjes ai kishte bartur revole me vete. Çështja gjithashtu është vërtetuar nga i bashkëpandehuri S. [redacted] dhe dëshmitari [redacted], i cili ka dëshmuar në prani të akuzuarit në gjykatë.

S.V.

A.F.

2. Mungesa e të akuzuarit gjatë shpalljes së aktgjykimit:

Edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt dhe i përfaqësuar nga avokati i tij mbrojtës, i akuzuari gjithashtu nuk ka qenë prezent as gjatë 30 nëntorit 2011, ditën e shpalljes së aktgjykimit.

Sidoqoftë, Gjykata Supreme gjen se sipas nenit 392 të KPPK-së, Kodi lejon që aktgjykimi të shpallet në mungesë të të akuzuarit.

3. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës në fazën e apelit tanimë ka marrë parasysh dhe ka vlerësuar drejtë dhe në mënyrë korrekte të gjitha aspektet relevante siç janë adresuar përsëri në kontekstin në fjalë.

Në veçanti, Gjykata Supreme ka theksuar se— edhe pse prezenca e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor është e natyrës obligative sipas rregullave procedurale të Kosovës— KPPK-ja parasheh disa përjashtime nga ky parim, si në veçanti shpallja e aktgjykimit në mungesë të palës sipas nenit 392 paragrafit 3 të KPPK-së apo largimi i të akuzuarit nga gjykatorja në rast të prishjes së rendit sipas nenit 336 paragrafit 2 të KPPK-së. Prandaj, procedura në mungesë ka qenë e njohur sipas ligjit të vjetër.

Gjithashtu vlen të përmendet se mbajtja e gjykimi në mungesë të të akuzuarit nën mbrojtjen strikte të procedurës është i mundshëm në disa sisteme ligjore Evropiane, e që për këtë arsye një shprehje e tillë nuk është domosdoshmërisht në kundërshtim me KEDNJ-në, por në përputhje me standardet Evropiane.

Përveç kësaj, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ) ka theksuar se gjykimi në mungesë duhet t'i siguroj garancitë e gjykimit të drejtë sipas KEDNJ-së e cila do të respektohet gjatë të gjitha fazave të procedurës¹. GjEDNJ në këtë kontekst ka përcaktuar disa standarde minimale që duhet respektuar dhe në veçanti ka theksuar se autoritetet nacionale duhet të demonstrojnë përkushtim të duhur gjatë përpjekjeve për ta gjetur të akuzuarin dhe ta njoftojnë individin në lidhje me akuzat dhe detajet e rastit.

Respektimi i procedurës së tillë me garancitë e gjykimit të drejtë varet nga rrethanat e lëndës dhe duhet të ekzaminohet në bazë të lëndëve veç e veç.

Sidoqoftë, Gjykata Supreme e Kosovës gjen se të gjitha kushtet janë plotësuar në lëndën në fjalë dhe prandaj ka vendosur si në dispozitiv.

¹ GjEDNJ, Poitrimol kundër Francës, kërkesa nr. 14032/88, aktgjykimi i datës 23 nëntor 1993, par. 34 ff.

Kryetar i kolegjit:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtës:

Holger Ehgelmann
Zyrtar ligjor

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
PML.-KZZ. Nr. 44/2013
Prishtinë
14 gusht 2013